

UDHËZIM
Nr. 81, datë 6.3.2020

**PËR KLASIFIKIMIN E OBJEKTEVE, SIPAS RREZIKSHMËRISË NGA ZJARRI,
PROCEDURAT E SHQYRTIMIT DHE TË MIRATIMIT TË PROJEKTIT TË
MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN, SI DHE DHËNIA E
CERTIFIKATËS SË SIGURISË NGA ZJARRI**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3, të nenit 41, të ligjit nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”,

UDHËZOJ:

I. KLASIFIKIMI I OBJEKTEVE SIPAS RREZIKSHMËRISË NGA ZJARRI

1. Objektet/aktivitetet, sipas rrezikshmërisë nga zjarri, pranisë së substancave të djegshme, madhësisë apo kompleksitetit që paraqesin, klasifikohen në 3 (tri) kategori:

- a) A, “Objekte/aktivitete me risk të ulët”;
- b) B, “Objekte/aktivitete me risk të mesëm”;
- c) C, “Objekte/aktivitete me risk të lartë”.

2. Objektet/aktivitetet të klasifikuara, sipas pikës 1, të këtij kreu, u nënshtrohen kontrolleve për parandalimin e zjarrit, sipas parimit të proporcionalitetit në identifikimin e shkallës së rrezikut ndaj zjarrit.

3. Në kategorinë A, “Objekte/aktivitete me risk të ulët”, përfshihen objektet/aktivitetet, që paraqesin:

- a) një nivel të kufizuar të rrezikut ndaj zjarrit;
- b) shkallë të ulët të ndezshmërisë së substancave të djegshme të pranishme;
- c) rrezikshmëri të ulët dhe të limituar të përhapjes së zjarrit.

3.1 Për kategorinë A nuk është i domosdoshëm hartimi i një projekti të plotë të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, sipas kategorisë që i përket, por mjafton hartimi i “Relacionit teknik” për mbrojtjen pasive dhe aktive të tërësisë së masave për sigurinë nga zjarri dhe shpëtimin.

4. Në kategorinë B, “Objekte/aktivitete me risk të mesëm”, përfshihen objektet/aktivitetet, që paraqesin:

- a) shkallë të mesme të ndezshmërisë së substancave të djegshme të pranishme;
- b) rrezikshmëri të kufizuar të përhapjes së zjarrit.

4.1 Për kategorinë B është e nevojshme të hartohet një projekt i plotë i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, sipas kategorisë që i përket. Shërbimi vendor i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, në vijim “MZSH”, verifikon përputhshmërinë e projektit të mbrojtjes nga zjarri me normat teknike të sigurisë nga zjarri dhe shpëtimin dhe, pasi e miraton, kryen inspektime për zbatimit të tij.

5. Në kategorinë C, “Objekte me risk të lartë”, ku përfshihen edhe objektet/aktivitetet me rëndësi ekonomiko-strategjike kombëtare, paraqesin:

- a) shkallë të lartë të ndezshmërisë së substancave, të cilat favorizojnë përhapjen e zjarrit;
- b) rrezikshmëri të theksuar të rënies, përhapjes së zjarrit, si dhe për shpërthim.

5.1 Për kategorinë C është e nevojshme të hartohet një projekt i plotë i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, sipas kategorisë që i përket. Para miratimit të projektit, shërbimi vendor i MZSH-së duhet të kryejë inspektime dhe verifikime në objekt/aktivitet dhe mund të kërkojë ndryshime të projektit të paraqitur, me qëllim respektimin e normave teknike të sigurisë nga zjarri dhe shpëtimin.

**II. SHQYRTIMI I PROJEKTTIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN DHE
PROCEDURA E MIRATIMIT**

1. Projekti i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objektet të kategorizuara në kreun I të këtij udhëzimi, është pjesë përbërëse e dokumentacionit tekniko-ligjor që kërkohet për lëshimin e

lejes së zhvillimit/ndërtimit të objekteve të reja, të atyre ekzistuese, si dhe për çdo ndryshim të destinacionit të objektit/aktivitetit.

2. Projekti i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin paraqitet për shqyrtim dhe për miratim nëpërmjet sistemit elektronik *e-Leje*, së bashku me aplikimin për leje zhvillimi/ndërtimi.

3. Shërbimi i MZSH-së, nëpërmjet sistemit elektronik *e-Leje*, shqyrton dhe mund të japë mendim, të pranojë, të miratojë apo të refuzojë kërkesën për miratimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

4. Për objektet me rëndësi ekonomiko-strategjike kombëtare, me rrezikshmëri të theksuar të rënies, përhapjes së zjarrit dhe për shpërthim, si dhe për zhvillimet komplekse, sipas rregullores së zhvillimit të territorit, projekti i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin shqyrtohet nga shërbimi qendror i MZSH-së, në bashkëpunim me Sekretariatën Teknik të Këshilli Kombëtar të Territorit.

5. Shërbimi i MZSH-së, brenda 7 (shtatë) ditëve nga paraqitja e aplikimit për leje zhvillimi/ndërtimi, shqyrton:

- a) nëse subjekti legjitimohet për të paraqitur kërkesë;
- b) plotësimin e saktë të të gjitha të dhënave të detyrueshme, sipas formularëve nr. 1 dhe nr. 1/1, “Vlerësimi i projektit të MZSH-së”, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse të tij;
- c) paraqitjen e të gjitha dokumenteve (paraqitje grafike, relacioni teknik), të detyrueshme për miratimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;
- d) përputhshmërinë e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin me lejen e zhvillimit/ndërtimit, me planin e detajuar vendor, si dhe me normat teknike të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin;
- e) dokumentacionin e projektuesit (ekspertit zjarrfikës), i cili duhet të përmbajë edhe deklaratën e përgjegjësisë mbi përputhshmërinë e projektit, me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga zjarri;
- f) nëse është kryer pagesa e tarifës për vlerësimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

6. Nëse projekti i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin nuk është në përputhje me kushtet për dhënien e lejes së zhvillimit/ndërtimit, me planin e detajuar vendor, me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin për mbrojtjen nga zjarri apo, në rast se personi nuk legjitimohet për të paraqitur kërkesën, shërbimi i MZSH-së, në nivel vendor apo qendror, brenda afatit të përcaktuar në pikën 5, të këtij kreu, merr vendim të arsyetuar për refuzimin e kërkesës dhe njofton me shkrim aplikuesin.

7. Në rast se dokumentacioni i cili duhet të shoqërojë projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin rezulton i plotë, por nuk është kryer pagesa e tarifës për vlerësimin e këtij projekti, shërbimi i MZSH-së në nivel vendor apo qendror njofton aplikuesin që të kryejë pagesën brenda 5 ditëve nga njoftimi.

8. Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, shërbimi i MZSH-së, në nivel vendor apo qendror, njofton aplikuesin, që brenda 5 ditëve nga njoftimi të kryejë plotësimin e dokumentacionit.

9. Me dërgimin e njoftimeve, sipas pikave 7 dhe 8 të këtij kreu, afati për shqyrtimin e kërkesës pezullohet deri në plotësimin e dokumentacionit dhe/ose pagesës së tarifës nga aplikuesi. Nëse subjekti nuk plotëson dokumentacionin ose nuk paguan tarifën për vlerësimin e projektit, brenda afatit të caktuar, shërbimi i MZSH-së, në nivel vendor apo qendror, merr vendim të arsyetuar për refuzimin e kërkesës.

10. Refuzimi apo kthimi për plotësim të dokumentacionit tekniko-ligjor për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin nga punonjësi i autorizuar i shërbimit të MZSH-së bëhet i arsyetuar, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

11. Nëse shërbimi i MZSH-së, brenda afatit të përcaktuar në pikën 5 të këtij kreu, nuk njofton aplikuesin për mangësi në dokumentacion apo për detyrimin e pagesës së tarifës, projekti i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin konsiderohet i miratuar në heshtje dhe aplikimi për leje zhvillimi/ndërtimi dërgohet pranë autoritetit përgjegjës, sipas legjislacionit për planifikimin dhe për zhvillimin e territorit për marrjen e vendimit përfundimtar.

12. Në rast se dokumentacioni është i plotë dhe është kryer pagesa e tarifës të shërbimit, aplikimi konsiderohet i pranuar për shqyrtim të mëtejshëm dhe aplikimi për leje

zhvillimi/ndërtimi dërgohet pranë autoritetit përgjegjës, sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për marrjen e vendimit përfundimtar.

III. PROCEDURA E LËSHIMIT TË CERTIFIKATËS SË SIGURISË NGA ZJARRI

1. Certifikata e Sigurisë nga Zjarri, në vijim “CSZ”, sipas formularit nr. 2 dhe 2.1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, është akti administrativ i lëshuar nga shërbimi i MZSH-së, brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, nëpërmjet të cilit provohet përmbushja e kërkesave të parashikuara në projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, sipas kategorizimit të objekteve.

2. Aplikuesi për CSZ-në paraqet kërkesë nëpërmjet sistemit elektronik *e-Albania*, vetëm pasi ka përfunduar procesi i zhvillimit/i ndërtimit.

3. Kërkesa e aplikuesit për t’u pajisur me CSZ pranohet për vlerësim të mëtejshëm nga shërbimi i MZSH-së, në nivel vendor vetëm, në rastet kur:

- a) aplikuesi legjitimohet për të paraqitur kërkesë;
- b) provohet dhe dokumentohet shkresërisht procedura e miratimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objektin/aktivitetin;
- c) vërtetohet gjendja faktike e marrjes së masave pasive/aktive të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në përputhje me kushtet e lejes së zhvillimit/ndërtimit, si dhe dokumenteve të planifikimit;
- d) është kryer pagesa e tarifës për marrjen e CSZ-së.

4. Në rast se aplikuesi nuk përmbush kriterin e përcaktuar në germen “b”, të pikës 3 të këtij kreu, informohet për të rifilluar procedurën e miratimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

5. Inspektori i autorizuar i shërbimit të MZSH-së në nivel vendor, gjatë këqyrjes së gjendjes faktike në objekt/aktivitet të masave pasive/aktive të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, ka për detyrë të:

- a) plotësojë me përgjegjësi rubrikat e formularit nr. 3, “Vlerësimi i riskut nga zjarri”, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi;
- b) të hartojë relacionin shpjegues lidhur me gjetjet gjatë inspektimit në objekt/aktivitet, për masat e mbrojtjes nga zjarri, të cilin e paraqet pranë drejtuesit të shërbimit të MZSH-së.

6. Shërbimi i MZSH-së, në rast se konstaton mospërputhje të punimeve me kërkesat e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, lëshon aktin e konstatimit, duke dhënë sugjerimet përkatëse dhe afatin kohor për plotësimin e mangësive. Në këtë rast, afati për lëshimin e CSZ-së pezullohet.

7. Nëse brenda afatit kohor të përcaktuar në aktin e konstatimit, sipas pikës 6 të këtij kreu, nuk përmbushen sugjerimet e shërbimit të MZSH-së, inspektorët vendorë të MZSH-së vendosin sanksione për administratorët e objektit/aktivitetit apo subjektet përgjegjëse, sipas parashikimit të ligjit për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin dhe aplikimi për lëshimin e CSZ-së refuzohet.

8. Shërbimi i MZSH-së lëshon CSZ, në rastet kur:

- a) Relacioni shpjegues sipas gërmës “b”, të pikës 5 të këtij kreu, vërteton përmbushjen e detyrave të caktuara në projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;
- b) janë përmbushur kriteret e sigurisë, që kërkon legjislacioni për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, të pasqyruara nga inspektori i autorizuar në formularin nr. 3, “Vlerësimi i riskut nga zjarri”, në objekt/aktivitet.

9. Për objektet e kategorisë C, sipas pikës 1, të kreut I të këtij udhëzimi, inspektori i autorizuar i shërbimit vendor të MZSH-së, pas kërkesës së aplikuesit dhe pas verifikimit të kompetencës administrative, ka për detyrë të:

- a) verifikojë në vend objektin, lidhur me marrjen e masave pasive/aktive të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në përputhje me kushtet e lejes së zhvillimit/ndërtimit, si dhe dokumenteve të planifikimit;
- b) dërgojë pranë shërbimit qendror të MZSH-së, relacionin shpjegues të firmosur elektronikisht nga drejtuesi i shërbimit, lidhur me masat pasive/aktive për mbrojtjen nga zjarri.

9.1 Shërbimi qendror i MZSH-së, për objektet e kategorisë C, vlerëson plotësimin e kushteve dhe të standardeve të sigurisë nga zjarri dhe, brenda 30 ditëve nga paraqitja e aplikimit, duhet të marrë vendim për lëshimin apo refuzimin e kërkesës së aplikuesit.

10. Në rast se gjatë monitorimit periodik të zhvillimeve në territor, përmes sistemit elektronik *e-Leje* apo gjatë kontrollit të veprimtarisë së strukturave të shërbimit të MZSH-së, konstatohet se për objektet me rëndësi ekonomike-strategjike kombëtare, që paraqesin rrezikshmëri të theksuar të rënies, përhapjes së zjarrit dhe shpërthim apo për zhvillimet komplekse, sipas rregullores së zhvillimit të territorit, projekti i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin dhe CSZ-ja janë miratuar nga shërbimi vendor i MZSH-së, ndaj personave përgjegjës fillohet procedura e ecurisë disiplinore, sipas parashikimeve të legjislacionit për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

11. Afati i vlefshmërisë të CSZ është:

a) pa afat për objektet/aktivitetet të kategorisë A, sipas përcaktimit në germën “a”, të pikës 1, të kreut I të këtij udhëzimi;

b) me afat 5-vjeçar, me të drejtë ripërtëritje për objektet/aktivitetet të kategorisë B, sipas përcaktimit në germën “b”, të pikës 1, të kreut I të këtij udhëzimi;

c) me afat 3-vjeçar, me të drejtë ripërtëritje për objektet/aktivitetet të kategorisë C, sipas përcaktimit në germën “c”, të pikës 1, të kreut I të këtij udhëzimi.

12. Afatet e përcaktuara në gerrat “b” dhe “c”, të pikës 12 të këtij kreu, janë të vlefshme në rastet kur objektet/aktivitetet nuk ndryshojnë elemente thelbësore të strukturës së tyre apo nuk ndryshojnë destinacionin e përdorimit. Në rast të kundërt, pronarët apo administratorët e këtyre objekteve/aktiviteteve janë të detyruar të aplikojnë për miratim shtesë të projektit ekzistues të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe për ripërtëritje të CSZ-së, në përputhje me treguesit dhe mënyrat e ndërhyrjes në projekt, instalimet e reja, modifikim, zgjerim apo rikonstruksion i aktivitetit ekzistues.

13. Shërbimi i MZSH-së, në nivel vendor apo qendror, mund të revokojë CSZ të lëshuar, në rastet kur:

a) pas procedurës së inspektimit, kryesisht apo të autorizuar, objekti/aktiviteti nuk përmbush kushtet dhe standardet në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, sipas kategorizimit të objekteve;

b) nga inspektorët vendorë të shërbimit të MZSH-së konstatohen shkelje të rënda ose ndryshime thelbësore në kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojë objekti/aktiviteti, sipas projektit të miratuar dhe certifikatës së lëshuar;

c) konstatohen të dhëna të rreme në dokumentet e aplikimit të subjektit.

14. Vendimi i marrë nga drejtuesi i shërbimit të MZSH-së për revokimin e CSZ-së duhet të jetë i arsyetuar dhe ndaj tij lejohet ankim në Gjykatën Administrative kompetente, brenda afateve dhe sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin përkatës në fuqi.

IV. PROCEDURAT E RIPËRTËRITJES SË CERTIFIKATËS TË SIGURISË NGA ZJARRI

1. Për ripërtëritjen e CSZ-së, sipas formularëve nr. 4 dhe 4/1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, për objektet/aktivitetet e kategorisë B dhe C, sipas pikës 1, të kreut I të këtij udhëzimi, subjekti paraqet kërkesë në bashkinë përkatëse, ku ndodhet objekti apo ushtrohet aktiviteti, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara mbarimit të afatit të vlefshmërisë së saj.

2. Me paraqitjen e kërkesës për ripërtëritjen e CSZ-së, shërbimi i MZSH-së në nivel vendor:

a) për objektet/aktivitetet e kategorisë B planifikon inspektim të autorizuar për të verifikuar respektimin e normave dhe standardeve në fushën e sigurisë nga zjarri;

b) për objektet/aktivitetet e kategorisë C, pas verifikimit në vend të objektit/aktivitetit, lidhur me përputhshmërinë e masave aktive/pasive të mbrojtjes nga zjarri, dërgon shkresërisht relacion shpjegues, si dhe çdo akt teknik për mbrojtjen nga zjarri të lëshuar për objektin/aktivitetin përkatës, lidhur me gjetjet dhe gjendjen faktike të masave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, pranë shërbimit qendror të MZSH-së, i cili rast pas rasti lëshon/refuzon certifikatën përkatëse.

3. Procedura për lëshimin e CSZ-së e parashikuar në kreun III të këtij udhëzimi, do të zbatohet edhe në rastin e ripërtëritjes periodike të saj.

4. Gjatë procedurës së ripërtëritjes së CSZ-së, së cilës i ka kaluar afati i vlefshmërisë, ajo do të konsiderohet e vlefshme deri në përfundim të afateve të parashikuara në këtë udhëzim, për shqyrtimin e kërkesës për ripërtëritjen e saj.

V. ADMINISTRIMI I DOKUMENTACIONIT TEKNIK QË SHËRBEN PËR VLERËSIMIN E PROJEKTTIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN DHE CERTIFIKATËS SË SIGURISË NGA ZJARRI

1. Dokumentacioni tekniko-ligjor (relacioni teknik) që shoqëron projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, përgatitur nga një ekspert i licencuar, sipas pikës 4, të nenit 49, të ligjit nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, në rastin e objekteve/aktiviteteve të kategorisë A, B, C, që nuk janë sipas normave teknike dhe standardeve në fushën e MZSH-së, përmban:

a) Identifikimin e rreziqeve nga zjarri, bazuar në:

- substancat e rrezikshme dhe mënyrat e tyre të ruajtjes;
- ngarkesa e zjarrit në ndarje të ndryshme të objektit;
- sistemet teknologjike të shërbimit;
- zonat me rrezik të veçantë;
- llojin e sistemeve elektrike normale apo të sistemeve tokësore me referenca specifike ndaj rregullave për mbrojtjen nga zjarri.

b) Përshkrimin e kushteve mjedisore duke vlerësuar riskun, në lidhje me:

- aksesueshmërinë dhe qëndrueshmërinë;
- përshkrimi i distancave, ndarjet, izolimi;
- karakteristikat e ndërtesave (llojet e ndërtesës, gjeometria, volumi, sipërfaqet, lartësitë, dyshemetë nëntokësore, nëndarjet etj.);

- ventilimin;
- vende të konsideruara të sigurta;
- rrugët e evakuimit.

c) Përpunimet grafike (disenjim grafik), planimetria e përgjithshme në shkallë (nga 1:2000 deri në 1:200), ku përfshihen:

- vendndodhja e veprimtarisë në lidhje me zonën përreth;
- distanca të jashtme të sigurisë;
- burimet ujore në zonë (hidrantët e jashtëm, pusët, ujësjellësit publikë etj.);
- sistemet e jashtme teknologjike (nënstationet elektrike, linjat elektrike, rrjetet e gazit, sistemet e shpërndarjes së gazit teknik etj.);

- vendndodhjen e pajisjeve manovruese të impianteve të mbrojtjes nga zjarri dhe të blloqeve emergjente të sistemeve teknologjike;

- planet, seksionet dhe lartësitë në shkallë (1:50, 1:100 ose 1:200) të ndërtesave, instalimeve, depove, distancat e sigurisë, vendndodhjen e pajisjeve të zjarrfikësve, përdorimin e objekteve, ndriçimin e sigurisë.

2. Punonjësi i shërbimit të MZSH-së në nivel vendor, i autorizuar për inspektimin, sipas pikës 5, të kreut III të këtij udhëzimi, pas vlerësimit dhe miratimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në çdo rast mban kopje të këtij projekti dhe të çdo dokumenti tjetër që lidhet me procedurat e vlerësimit, miratimit, refuzimit, si dhe të plotësimit të dokumentacionit nga sistemi elektronik i lejeve.

3. Dokumentacioni që shërbimi i MZSH-së duhet të shqyrtojë, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi, administrohet dhe ruhet në dosje përkatëse për çdo objekt, në përputhje me afatet e parashikuara nga legjislacioni për arkivat. Çdo akt i dosjes duhet të ketë numër unik, i cili identifikon objektin/aktivitetin të pasuar në mënyrë progresive nga numra me fraksion, sipas rendit rritës.

4. Në rastet kur veprohet sipas parashikimeve të pikës 4, të kreut të II, dokumentacioni administrohet nga shërbimi i MZSH-së në nivel vendor dhe qendror.

5. Shërbimi i MZSH-së, në nivel vendor dhe qendror, mban dhe administron regjistra me fletë të numërtuara dhe të sekretuara me vulë nga protokollin dhe të emërtuar:

a) regjistri i miratimit të projekteve të mbrojtjes nga zjarri, sipas formularit nr. 5, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

b) regjistri i certifikatave të sigurisë nga zjarri, sipas formularit nr. 5/1, bashkëlidhur këtij dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

c) registri i ripërtëritjes së certifikatave të sigurisë nga zjarri, sipas formularit nr. 5/2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

6. Regjistrat e emërtuar, sipas pikës 5 të këtij kreu, shërbejnë si inventar për administrimin e shkresave gjatë veprimtarisë së shërbimit të MZSH-së, që krijohet, ruhet, mirëmbahet, administrohet dhe përditësohet, në mënyrë të pavarur nga struktura inspektuese të këtij shërbimi.

7. Regjistrat e emërtuar, sipas pikës 5 të këtij kreu prodhohen pranë Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë, sipas legjislacionit për prokurimin publik.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij udhëzimi.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për sigurimin e zbatimit dhe kontrollin e zbatimit të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSSHËM
Sandër Lleshaj

Formulari nr.1

STEMA E BASHKISË
BASHKIA
DREJTORIA/SEKTORI I MZSH

FORMULARI I VLERËSIMIT TË PROJEKTIT TË MZSH

I nënshkruari			
	Emri	Mbiemri	
Banues në	adresa	Numri i identifikimit të letërnjoftimit	Bashkia
	telefoni	Numri i NIPTIT të personit fizik	
	telefax	Adresa e postës elektronike	
Në cilësinë e			
personit:	Statusi zyrtar (pronari, përfaqësuesi ligjor, avokat, administratori, pronari, menaxher, etj)		
dhe	Emri i objektit/aktivitetit, ndërmarrje, institucion, korporatë, shoqatë, etj		
Bazuar në	adresa	Bashkia	zona
	telefoni	telefax	Adresa e postës elektronike

Në përputhje me nenin 39, pikën 1, 2, 4 të nenit 41 të ligjit nr.152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", **vlerësoj** dhe

MIRATOJ

PROJEKTIN E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN

Për objektin e			
	Lloji i punës (zgjidhjes së re, modifikim, zgjerim, rinovim, etj)		
Aktivitetin lidhur			
	Lloji i objektit, lloji i biznesit, aktivitetit (objekt banimi, hotel, shkollë, etj)		
Të vendosura në			
	bashkia	zona	telefoni
t			
	Dokumentacioni teknik është nënshkruar nga eksperti zjarrfikës		
	Numri i lejes	Emri	Mbiemri
Eksperti zjarrfikës regjistruar si person fizik/juridik			Nr. regjistrimit
	adresa		Numri i regjistrimit NIPT
	bashkia	zona	telefoni
	Adresa e postës elektronike		

Hapësira për shënime për shërbimin e MZSH-së

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

- a) INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME LIDHUR OBJEKTIN DHE AKTIVITETIN QË USHTROHET LIDHUR ME MASAT E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN.

- b) TREGUESIT DHE MËNËYRAT E NDËRHYRJES NË PROJEKT: INSTALIMI I RI ose MODIFIKIM, ZGJERIMIN APO RISTRUKTURIMIN I AKTIVITETIT EKZISTUES.

FORMULARI I VLERËSIMIT TË PROJEKTIT TË MZSH

Bashkëlidhur këtij formulari paraqiten nga projektuesi apo investitori aplikues, apo personi i autorizuar dokumentet e mëposhtme të projektit, të nënshkruar nga një ekspert zjarrfikës i licencuar në përputhje me pikën 4 të nenit 49 të ligjit nr.152/2015.

- Relacioni teknik;
- Dokumentacioni (dizajni) grafik.

Formulari Informativ i vlerësimit të projektit të MZSH-së plotësohet në dy kopje. Njëra kopjet i jepet aplikuesit pas miratimit të projektit dhe kopja tjetër administrohet nga shërbimi i MZSH-së, së bashku me dokumentacionin e përcaktuar.

(Nga punonjësi i autorizuar për të miratuar projektin e MZSH-së hartohet procesverbal për inventarin e dokumenteve që paraqet aplikuesi dhe ky procesverbal administrohet së bashku me dokumentacionin e sipërcituar).

INSPEKTORI I AUTORIZUAR;
(Emër/mbiemër/firmë)

DREJTORI/SHEFI I SEKTORIT TË MZSH
(Emër/mbiemër/firmë/vulë)

Nr. Praktikës MZSH



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E MZSH

FORMULARI I VLERËSIMIT TË PROJEKTIT TË MZSH

FORMULARI I VLERËSIMIT TË PROJEKTIT TË MZSH

I nënshkruari				
	Emri		Mbiemri	
Banues në	adresa		Bashkia	
			Numri i identifikimit të letërnjoftimit	
	telefoni		Numri i NIPTIT të personit fizik	
	telefaks		Adresa e postës elektronike	
Në cilësinë e personit:				
	Statusi zyrtar (pronari, përfaqësuesi ligjor, avokat, administratori, pronari, menaxher, etj)			
dhe	Enri i objektit/aktivitetit, ndërmarrje, institucion, korporatë, shoqatë, etj			
Bazuar në	adresa			
	Bashkia		zona	telefoni
	telefaks		Adresa e postës elektronike	

Në përputhje me nenin 39, pikën 1, 2, 4 të nenit 41 të ligjit nr.152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", vlerësoj dhe

MIRATOJ

PROJEKTIN E MBOJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN

Për objektin e			
	Lloji i punës (zgjidhjes së re, modifikim, zgjerim, rinovim, etj)		
Aktivitetin lidhur			
	Lloji i objektit, lloji i biznesit, aktivitetit (objekt banimi, hotel, shkollë, etj)		
Të vendosura në			
	bashkia	zona	telefoni
t			
Dokumentacioni teknik është nënshkruar nga eksperti zjarfikës			
Numri i lejes	Emri	Mbiemri	
Eksperti zjarfikës regjistruar si person fizik/juridik		Nr. regjistrimit	
	adresa	Numri i regjistrimit NIPT	
	bashkia		
	telefon	Adresa e postës elektronike	

Hapësira për shënime për shërbimin e MZSH-së
--

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

- a) INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME LIDHUR OBJEKTIN DHE AKTIVITETIN QË USHTROHET LIDHUR ME MASAT E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN.

- b) TREGUESIT DHE MËNÝRAT E NDËRHYRJES NË PROJEKT: INSTALIMI I RI OSE MODIFIKIM, ZGJERIMIN APO RISTRUKTURIMIN I AKTIVITETIT EKZISTUES.

FORMULARI I VLERËSIMIT TË PROJEKTIT TË MZSH

Bashkëlidhur këtij formulari paraqiten nga projektuesi apo investitori aplikues, apo personi i autorizuar dokumentet e mëposhtme të projektit, të nënshkruar nga një ekspert zjarrfikës i licencuar në përputhje me pikën 4 të nenit 49 të ligjit nr.152/2015.

- Relacioni teknik; apo Raporti Teknik për Fillimin e Aktivitetit
- Dokumentacioni (dizajni) grafik.

Formulari i vlerësimit të projektit të MZSH-së plotësohet në dy kopje. Njëra kopjet i jepet aplikuesit pas miratimit të projektit dhe kopja tjetër administrohet nga shërbimi i MZSH-së, së bashku me dokumentacionin e përcaktuar.

(Punonjësi i autorizuar për të miratuar projektin e MZSH-së harton procesverbal për inventarin e dokumenteve që paraqet aplikuesi dhe ky procesverbal administrohet së bashku me dokumentacionin e sipërcituar).

DREJTORI I MZSH
(Emër/mbiemër/firmë/vulë)

Nr. Praktikës
MZSH

STEMA E BASHKISË
BASHKIA _____
DREJTORIA/SEKTORI I MZSH

Formulari nr. 2

CERTIFIKATË PËR SIGURINË NGA ZJARRI

Mbështetur në pikën 2 të nenit 3, pikat 3, 4 të nenit 41 të ligjit nr.152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, si dhe duke konsideruar kontrollin teknik të realizuar në objekt në datë _____.20_____, nga punonjësi i autorizuar i MZSH (emër mbiemër i Inspektorit);

LËSHOJMË:

Certifikatën e Sigurisë nga Zjarri (CSZ), në datë _____.20_____, për respektimin e rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, për parandalimin e zjarreve, si dhe për ekzistencën e kushteve të sigurisë kundër zjarreve në objektin e kategorizuar (kategoria ____), sipas Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm.

Emri/adresa e objektit:

Aktiviteti i ushtruar në objekt:

Procesi i vlerësimit të projektit (miratimi nga shërbimi i MZSH);

☐ miratim fillestar i projektit të MZSH (data/muaji/viti)

Lëndët/substancat që paraqesin rrezik për zjarr apo shpërthim në objekt/aktivitet:

Sipërfaqja e përgjithshme e objektit/aktivitetit/lartësia/numri i kateve/mbi/nën nivelin zero:

Implantet aktive të mbrojtjes nga zjarri në objekt/aktivitet:

Mjetet për fikjen e zjarreve:

Instalime të fiksuara për Mbrojtjen nga Zjarri:

Implant për fikjen automatike të zjarreve (tip sprinkler):

Implant hidrik antizjarr në objekt/aktivitet (diametri i hidrantit të instaluar);

Implanti i fikseve të lëvizshme (numri në total i fikseve të zjarrit);

Implanti i diktimit/sinjalizimit të zjarrit/tymit (detektorët të instaluar) në objekt/aktivitet;

Rezerva hidrike në objekt/aktivitet:

INSPEKTORI I AUTORIZUAR;
(Emër/mbiemër/firmë)

DREJTORI/SHEFI I SEKTORIT TË MZSH
(Emër/mbiemër/firmë/vulë)

CERTIFIKATË PËR SIGURINË NGA ZJARRI

Certifikata e Sigurisë nga Zjarri hartohet në tre kopje, një kopje i jepet aplikuesit, një kopje qëndron në protokoll/arkiv dhe kopja tjetër administrohet në dosjen e objektit/aktivitetit.

**CERTIFIKATË PËR SIGURINË NGA ZJARRI
(RIPËRTËRITJE PËR LEJIM AKTIVITETI)**

Mbështetur në pikën 2 të nenit 3, pikat 3, 4 të nenit 41 të ligjit nr.152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, si dhe duke konsideruar kontrollin teknik të realizuar në datë _____.20____, nga punonjësi i autorizuar i MZSH (emër mbiemër i Inspektorit);

LËSHOJMË:

Certifikatën e Sigurisë nga Zjarri për lejin e ushtrimit të aktivitetit (CSZ), në datë _____.2019, për respektimin e rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, për parandalimin e zjarreve, si dhe për ekzistencën e kushteve të sigurisë kundër zjarreve në objektin e kategorizuar (kategoria ____), sipas Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm.

Emri/adresa e objektit:

Aktiviteti i ushtruar në objekt:

Procesi i vlerësimit të projektit (miratimi nga shërbimi i MZSH);

☐ miratim fillestar i projektit të MZSH ☐ modifikim i projektit të MZSH, sipas aktivitetit që ushtrohet/lejohet (data/muaji/viti)

Lëndët/substancat që paraqesin rrezik për zjarr apo shpërthim në objekt/aktivitet:

Sipërfaqja e përgjithshme e objektit/aktivitetit/lartësia/numri i kateve/mbi/nën nivelin zero:

Implantet aktive të mbrojtjes nga zjarri në objekt/aktivitet:

Mjetet për fikjen e zjarreve:

Instalime të fiksuara për Mbrojtjen nga Zjarri:

Implant për fikjen automatike të zjarreve (tip sprinkler):

Implant hidrik antizjarr në objekt/aktivitet (diametri i hidrantit të instaluar);

Implanti i fikseve të lëvizshme (numri në total i fikseve të zjarrit);

Implanti i diktimit/sinjalizimit të zjarrit/tymit (detektorët të instaluar) në objekt/aktivitet;

Rezerva hidrike në objekt/aktivitet: _____

INSPEKTORI I AUTORIZUAR;
(Emër/mbiemër/firmë)

DREJTORI/SHEFI I SEKTORIT TË MZSH
(Emër/mbiemër/firmë/vulë)

RIPËRTËRITJE CERTIFIKATE PËR SIGURINË NGA ZJARRI
(PËR LEJIM AKTIVITETI)

Certifikata e Sigurisë nga Zjarri (Ripërtëritje për lejim aktiviteti) hartohet në tre kopje, një kopje i jepet aplikuesit, një kopje qëndron në protokoll/arkiv dhe kopja tjetër administrohet në dosjen e objektit/aktivitetit.



CERTIFIKATË PËR SIGURINË NGA ZJARRI

Mbështetur në pikën 2 të nenit 3, pikat 3, 4 të nenit 41 të ligjit nr.152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", si dhe duke konsideruar kontrollin teknik të realizuar në objekt në datë _____.20____, nga punonjësi i autorizuar i MZSH (emër mbiemër i Inspektorit);

LËSHOJMË:

Certifikatën e Sigurisë nga Zjarri (CSZ), në datë _____, për respektimin e rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, për parandalimin e zjarreve, si dhe për ekzistencën e kushteve të sigurisë kundër zjarreve në objektin e kategorizuar (kategoria ____), sipas Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm.

Emri/adresa e objektit:

Aktiviteti i ushtruar në objekt:

Procesi i vlerësimit të projektit (miratimi nga shërbimi i MZSH);

☐ miratim fillestar i projektit të MZSH (data/muaji/viti)

Lëndët/substancat që paraqesin rrezik për zjarr apo shpërthim në objekt/aktivitet:

Sipërfaqja e përgjithshme e objektit/aktivitetit/lartësia/numri i kateve/mbi/nën nivelin zero:

Implantet aktive të mbrojtjes nga zjarri në objekt/aktivitet:

Mjetet për fikjen e zjarreve:

Instalime të fiksuara për Mbrojtjen nga Zjarri:

Implant për fikjen automatike të zjarreve (tip sprinkler):

Implant hidrik antizjarr në objekt/aktivitet (diametri i hidrantit të instaluar);

Implanti i fikseve të lëvizshme (numri në total i fikseve të zjarrit);

Implanti i diktimit/sinjalizimit të zjarrit/tymit (detektorët të instaluar) në objekt/aktivitet;

Rezerva hidrike në objekt/aktivitet:

DREJTORI I MZSH
(Emër/mbiemër/firmë/vulë)

15

Certifikata e Sigurisë nga Zjarri hartohet në tre kopje, një kopje i jepet aplikuesit, një kopje qëndron në protokoll/arkiv dhe kopja tjetër administrohet në dosjen e objektit/aktivitetit.





**CERTIFIKATË PËR SIGURINË NGA ZJARRI
(RIPËRTËRITJE PËR LEJIM AKTIVITETI)**

Mbështetur në pikën 2 të nenit 3, pikat 3, 4 të nenit 41 të ligjit nr.152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, si dhe duke konsideruar kontrollin teknik të realizuar në datë _____.20____, nga punonjësi i autorizuar i MZSH (emër mbiemër i Inspektorit);

LËSHOJMË:

Certifikatën e Sigurisë nga Zjarri për lejin e ushtrimit të aktivitetit (CSZ), në datë _____.20____, për respektimin e rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, për parandalimin e zjarreve, si dhe për ekzistencën e kushteve të sigurisë kundër zjarreve në objektin e kategorizuar (kategoria ____), sipas Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm.

Emri/adresa e objektit:

Aktiviteti i ushtruar në objekt:

Procesi i vlerësimit të projektit (miratimi nga shërbimi i MZSH);

☐ miratim fillestar i projektit të MZSH
ushtrohet/lejohe (data/muaji/viti)

☐ modifikim i projektit të MZSH, sipas aktivitetit që

Lëndët/substancat që paraqesin rrezik për zjarr apo shpërthim në objekt/aktivitet:

Sipërfaqja e përgjithshme e objektit/aktivitetit/lartësia/numri i kateve/mbi/nën nivelin zero:

Implantet aktive të mbrojtjes nga zjarri në objekt/aktivitet:

Mjetet për fikjen e zjarreve:

Instalime të fiksuar për Mbrojtjen nga Zjarri:

Implant për fikjen automatike të zjarreve (tip sprinkler):

Implant hidrik antizjarr në objekt/aktivitet (diametri i hidrantit të instaluar);

Implanti i fikseve të lëvizshme (numri në total i fikseve të zjarrit);

Implanti i diktimit/sinjalizimit të zjarrit/tymit (detektorët të instaluar) në objekt/aktivitet;

Rezerva hidrike në objekt/aktivitet:

DREJTORI I MZSH
(Emër/mbiemër/firmë/vulë)

Certifikata e Sigurisë nga Zjarri (Ripërtëritje për lejim aktiviteti) hartohet në tre kopje, një kopje i jepet aplikuesit, një kopje qëndron në protokoll/arkiv dhe kopja tjetër administrohet në dosjen e objektit/aktivitetit.

RIPËRTËRITJE CERTIFIKATE PËR SIGURINË NGA ZJARRI
(PËR LEJIM AKTIVITETI)

VLERËSIM I RISKUT NGA ZJARRI PËR OBJEKTIN/AKTIVITETIN

VLERËSIM I RISKUT NGA ZJARRI PËR OBJEKTIN/AKTIVITETIN

I. Vendndodhja: _____

2. Administratori: _____

II. KARTELA E MBROJTJES NGA ZJARRI PËR OBJEKTIN.

1. Kufizimet dhe largësitë (m) me objektet kufizuese :

- Veriu: _____ // _____ m.
- Lindja: _____ // _____ m.
- Jugu: _____ // _____ m.
- Perëndimi: _____ // _____ m.

2. Numri i kateve dhe destinacioni i tyre:

- Mbi tokë: _____ // _____
- Nën tokë: _____ // nëse ka parking: numri i makinave _____, nëse jo: destinacioni _____

3. Numri i hyrje/daljeve vertikale (kafazet e shkallëve):

4. Sistemi Hidrik i Mbrojtjes nga Zjarri:

Hidrantë të jashtëm dhe të brendshëm për çdo kat:

Po ☐ Jo ☐

Numri i hidrantëve të
brendshëm _____

6. Sistemi Automatik i Fikjes së Zjarrit:

Po ☐ Jo ☐

- Lloji: _____
- Vendi i vendosjes: _____

7. Sistem Diktim-Sinjalizimi:

Po ☐ Jo ☐

- Lloji: _____
- Vendi i vendosjes: _____

8. Sistemi elektrik: (përshkrim i shkurtër)

9. Fikset e zjarrit të instaluara në objekt dhe kapaciteti i tyre shuarës:

10. A ka sistem përçues të shkarkimeve atmosferike (rrufe pritës) Po ☐ Jo ☐

11. Pajisjet tjera për mbrojtjen nga zjarri në se ka:

Po ☐ Jo ☐

12. Lloji i ndriçimit të emergjencës nëse ka:

Po ☐ Jo ☐

13. Nga shërbimi i MZSH-së është miratuar projekt i mbrojtjes nga zjarri:

Po ☐ Jo ☐

Viti i miratimit të projektit të MZSH-së _____

14. Objekti a është i pajisur me Certifikatë të Sigurisë nga Zjarri:

Po ☐ Jo ☐

II. KARTELA E SHPËTIMIT NË RAST ZJARRI (EVAKUIMI).

1. Shkallë të jashtme emergjence (Evakuimi):

Po ☐ Jo ☐

2. Kafazi i shkallëve, tipi i shkallëve (përshkrim):

3. Qëndrueshmëria nga zjarri: _____ minuta.

5. Gjerësia e rampës së shkallës: _____ cm.

6. Karakteristikat e shkallës: -a- ngjitja: _____ cm; -b- shkelja: _____ cm.

7. Mënyra e largimit të tymrave nga kafazi i shkallëve në rast zjarri: _____

Çdo Informacion tjetër që mund të konsiderohet i rëndësishëm nga shërbimi i MZSH:

INSPEKTORI I MZSH

Emër/Mbiemër/firma

Inspektori i autorizuar i shërbimit të MZSH-së në nivel vendor pas autorizimit nga drejtuesi i shërbimit të MZSH-së, gjatë këqyrjes së gjendjes faktike në objekt/aktivitet të masave pasive/aktive lidhur me konformitetin e mbrojtjes nga zjarri, plotëson me përgjegjësi rubrikat e modularit të vlerësimit të riskut nga zjarri, në përputhje me parashikimet e projektit të MZSH-së të hartuar nga eksperti zjarrfikës. Modulari i Vlerësimit i Riskut nga Zjarri hartohet në dy kopje me përmbajtje të njëjtë nga inspektori i autorizuar i MZSH-së. Njëra kopje administrohet në dosjen e objektit dhe kopja tjetër qëndron në protokoll/arkiv.

Formulari nr. 5

[illegible]

REGJISTRI I RIPËRTËRITJES SË CERTIFIKATAVE TË SIGURISË NGA ZJARRI PËR LEJIM AKTIVITETI

Modulari nr. 5/2

[illegible]